



Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e
Kulturore i Shqiptarëve

Bul. *Ilinden*, F. Postal 171, Shkup, Maqedoni
Tel: +389(0)23215381,
<http://www.itsh.edu.mk>



Akademia e Shkencave e Shqipërisë

Sheshi *Fan Noli*, Tiranë, Shqipëri
Tel. +355 (0) 4 223 03 05
<http://www.akad.gov.al>

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Duke marrë parasysh interesin e dyanshëm për zhvillimin dhe bashkëpunimin institucional në fushën kërkimore-shkencore dhe në mbështetje të statuteve të tyre, Akademia e Shkencave e Shqipërisë (ASHSH) dhe Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore i Shqiptarëve (që në vijim do të referohen si Palë) lidhin këtë marrëveshje për bashkëpunim. Palët e marrëveshjes u pajtuan si vijon:

Neni 1

Palët do të bashkëpunojnë për përcaktimin e strategjisë së punës studimore. Do të krijohet një *këshill koordinues* për bashkërendimin e punës kërkimore-shkencore, të planeve dhe projekteve të punës shkencore.

Neni 2

Në pajtim me këtë Marrëveshje, palët do të këmbëjnë informacion dhe do të bashkëpunojnë për *botimin e dokumenteve, punimeve të veçanta dhe për botime të tjera* në fushën e albanologjisë dhe historiografisë. Në secilin rast konkret do të veprohet duke u mbështetur në kontrata të veçanta.

Neni 3

Palët do të ofrojnë informacion dhe bashkëpunim lidhur me organizimin e veprimtarive shkencore (konferencave, simpoziumeve, seminareve etj.) për ngjarje dhe figura historike.

Neni 4

Palët do të mundësojnë me kushte të veçanta *këmbimin dhe shfrytëzimin e materialeve arkivore dhe të literaturës shkencore* në interes të studiuesve të të dy institucioneve.

Neni 5

Palët do të ndihmojnë ndërsjelltas studiuesit për kryerjen e veprimtarisë kërkimore në Shqipëri dhe në Maqedoni.

Neni 6

Punonjësit shkencorë të të dy institucioneve, pjesëmarrës në *projekte të përbashkëta*, kanë detyrimin të dorëzojnë nga një kopje të dokumentacionit pranë shërbimit përkatës të secilit institucion.

Neni 7

Palët do të botojnë, sipas rastit, punimet e studiuësve të tyre në *revistat shkencore respektive*.

Neni 8

Palët do të bashkëpunojnë në *kualifikimin shkencor* të studiuësve, në të gjitha shkallët.

Neni 9

Palët do të shkëmbejnë të gjitha botimet e realizuara.

Neni 10

Përfaqësuesit e *këshillit koordinues* të të dy palëve do të takohen së paku një herë në vit, për të ndjekur ecurinë e realizimit të neneve të kësaj marrëveshje.

Neni 11

Marrëveshja mund të ndryshohet ose të plotësohet me miratimin e të dyja palëve. Marrëveshja është e vlefshme për një periudhë të pacaktuar, për aq kohë sa nuk denoncohet nga asnjëra prej palëve.

Neni 12


Marrëveshja është hartuar në gjuhë shqipe në katër kopje identike (nga dy kopje për secilën palë).

Marrëveshja hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit nga të dy palët.

Për Institutin e Trashëgimisë
Shpirtërore & Kulturore të Shqiptarëve
Shkup

Drejtori


Dr. Skënder Asani



Për Akademinë e Shkencave
të Shqipërisë

Kryetari

Akademik Muzafer Korkuti



Datë 15.04. 2016

Prot. 158

Vendi: Shkup, Republika e Maqedonisë